



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2020:183831

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05581000

C. nr. 702/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S. P. nga, të cilin me autorizim e përfaqëson Shefqet Rexha avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, të cilën me autorizim Alban Hashani e përfaqëson, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti për komepenzimin e diferencës së pagës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më datën 27.02.2024 mori, ndërsa më datën 16.04.2024 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S. P. ngadhe:

II. DETYROHET e paditura Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit S. P. nga, t’ia paguaj kompensimin e diferencës së pagës, dhe atë për shumën 43.84 euro, për çdo muaj që nga muaji janar i vitit 2018 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, gjithësej për 48 muaj, shumën prej 2,104.32 euro, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me detyrim.

III. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit S. P. nga, përtej shumës së gjykuar si në pikën II të këtij dispozitivi, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që të njëjtit t’ia kompensojë diferencën e pagës, edhe për periudhën nga muaji janar i vitit 2015 deri në muajin dhjetor të vitit 2017, respektivisht edhe për 36 muaj, nga 43.84 euro për çdo muaj, e në shumë të përgjithshme prej 1,578.24 euro, **SI E PABAZUAR.**

IV. DETYROHET e paditura, që paditësit në emër të kompenzimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t’ia paguaj shumën prej 540.00 euro, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi S. P. nga, përmes të autorizuarit të tij Shefqet Rexha, avokat nga Kamenica, më datën 23.12.2020, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, të cilën me autorizim Alban Hashani e përfaqëson, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti për komepenzimin e diferencës së pagës.

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i palës paditëse, avokati Shefqet Rexha nga Kamenica, në seancën përgaditore dhe gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se paditësit në bazë të kontratës mbi marëdhënien e punës, Sh.02 nr.40229, të datës 30.12.2019, i është përcaktuar titulli i punës Roje i objektit, pagë bruto 283.76 euro, dhe se nga viti 2015 i janë caktuar detyra shtesë dhe atë si mirëmbajtës në Palestrën e Sportit në Kamenicë dhe se që nga viti 2015 deri në vitin 2021, për 72 muaj, paditësi është dëmtuar finaciarisht në diferencë të pagës prej 43.84 euro, në muaj dhe gjithësej për 72 muaj, në shumë prej 3,156.00 euro. Tutje ka shtuar se kërkesën për shkak të diferencës në page, për paditësin e ka bërë duke krahasuar pagën që ka pasur paditësi me koficientin 4 me pagën bruto në vlerë prej 283.76 euro, në pozitën e rojës së objektit që kishte para vitit 2015, ndërsa në vitin 2015 në pozitën e mirëmbajtësit në Palestrën e Sportit në Kamenicë, e cila pozitë sipas konkursit Sh.02 nr.35071, të datës 06.11.2019, nga Komuna e Kamenicës, për pozitën e tillë është koficienti 5, me pagë bruto 327.60 euro. I njëjti ka theksuar se Kryetari i Komunës, në vitin 2018, përmes një shkrese e ka obliguar paditësin të kryej detyra të tjera si Mirëmbajtës i objektit të Palestrës, por duke mos i'a ngritur pagën për pozitën e tillë. E në bazë të lartëcekurave, gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave materiale dhe personale, kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia bëjë kompensimin e diferencës së pagës dhe atë nga viti 2015 deri në vitin 2021, për 72 muaj, në diferencë të pagës për 43.84 euro në muaj, e gjithësej në shumën prej 3,156.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë në emër të përfaqësimit në 4 seanca gjyqësore për secilën nga 135.00 euro, shumë prej 540.00 euro.

I autorizuari i palës së paditur Alban Hashani, jurist nga Kamenica, në seancën përgaditore dhe gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklarimeve nga seancat e kalaura dhe se ka kontestuar afatshmerinë e paraqitjes së padisë, për shkak se sipas të njëjtit, paditësi padinë e ka dorëzuar në Gjykatë më datën 23.12.2020, e që e njëjta është në kundërshtim me nenin 79 dhe 78 të Ligjit të punës. Gjithashtu, ka theksuar se duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të punës, të drejtat lidhur me kompensimin në pagë parashkruhen në afat prej 3 vitesh. Andaj, mbi bazën e këtyre dhe pas administrimit të provave i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit t'a hudhë poshtë si të pasafatshme, ndërsa shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: kërkesa e palës paditese e datës 02.10.2020, drejtuar Komunës së Kamenicës, Kontrata e Punës e datës 30.12.2019, në emër të Safet Peci, formulari për vlerësim të rezultateve në punë në emër të S. P., të datës 20.12.2019, njoftimi i lëshuar nga Kryetari i Komunës së Kamenicës, i datës 10.11.2018, vendimi për formimin e Komisionit për kontrollimin dhe pranimin teknik, me numër 35386, i datës 18.11.2015, i Kryetarit të Komunës së Kamenicës, Konkursi për plotesimin e vendeve të punës i datës 06.11.2019, i hapur nga Komuna e Kamenicës, Vendimi për caktimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave të datës 11.06.2018, i lëshuar nga Zyra e Prokurimit të Komunës së Kamenicës.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, konform dispozitës së nenit 8, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për këto arsye:

Për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka punuar te paditura, si Roje e objektit të palestrës, por edhe më vonë si mirëmbajtës i palestrës së Sportit në Kamenicë, mirëpo për të padituren kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadiës se paditësit, për kompensimin e diferencës së pagave, e po ashtu, fakt kontestues për të paditurën ishte edhe çështja e parashkrimit të se drejtës së paditësit për të kërkuar kompensimin e differences se pagave, e për të cilat fakte gjykata i analizoi dhe vlerësoi sin ë vijim:

2.1. Provat materiale

Në bazë të kërkesës së palës paditese, të datës 02.10.2020, drejtuar Komunës së Kamenicës, gjykata vërtetoi faktin se S. P. nga, tani paditës, i është drejtuar A. I. -Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport – Kamenicë dhe Kryetarit të Komunës Z. Qëndron Kastrati, me kërkesë për, kompenzimin e diferencës së pagës, në vlerë prej 43.84 euro për çdo muaj që nga viti 2015, duke llogaritur edhe vlerën e përvojës në punë për shkak se kjo pozitë si Mirëmbajtës në Palestrën e Sportit në Kamenicë, është e caktuar me Koeficienti 5, Paga Bruto 327.60 euro, ndërsa i njëjti vazhdon të merr pagën e njëjtë që e ka pasur të përcaktuar sipas pozitës Roje e objektit dhe i ka bashkangjitur Kontratën mbi Marrëdhënien e Punës Sh. 02 Nr. 40229 datës 30.12.2019, Njoftimin Sh.02.Nr.844 datës 10.01.2018, Vlerësimin e rezultateve në punë, Formularin e datës.20.12.2009.

Në bazë të kontrata së punës, të datës 30.12.2019, në emër të Safet Peci, gjykata vërtetoi faktin se S. P., tani paditës nga, ka lidhur kontratë për marrëdhënie të punës me Komunën e Kamenicës, e përfaqësuar nga Z. Qëndron Kastrati, Kryetar, me përmbajtje sipas kontratës në njësinë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte, në Sektorin Teknik, me titullin e pozitës Roje i Objektit, 40 orë pune në javë, me kohëzgjatje të Kontratës nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020, me pagë bruto 283.76 euro. kontratë kjo e nënshkruar nga Kryetari i Komunës Z.Q. K. dhe S. P..

Në bazë të formularit për vlerësim të rezultateve në punë në emër të S. P., të datës 20.12.2019, gjykata vërtetoi faktin se S. P. nga si Mirëmbajtës i palestrës Sportive është vlerësuar me

notë 3, në bazë të objektivave/detyrave të pozitës së punës, nga vlerësuesi A. A., përgjegjës i Sportit, më datë 20.12.2019 dhe është nënshkruar nga të njëjtit, pa vërejtje.

Në bazë të njoftimit i lëshuar nga Kryetari i Komunës së Kamenicës, me datë 10.11.2018, gjykata vërtetoi faktin se z. Q. K., Kryetar Komunes përmes këtij njoftimi ka kërkuar nga z. A. A., që punët dhe detyrat tij të korrespondojnë me Rregulloren Sh.01 nr. 36827 te dt. 31.08.2017, në harmoni me nenin 5, nenin 7 paragrafi 11 dhe nenin 10 të kësaj rregullore. Ndërsa, S. P. është obliguar që krahas punëve dhe detyrave tjera të bëjë edhe mirëmbajtjen e objektit të palestres, deri në një ri-organizim të ri me orar nga ora 16:00 deri ne 22:00.

Në bazë të vendimit për formimin e Komisionit për kontrollimin dhe pranimin teknik, me numër 35386, të datës 18.11.2015, i Kryetarit të Komunës së Kamenicës, gjykata vërtetoi faktin se Kryetari i Komunës, Begzad Sinani, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Qeverisjen Lokale nr.03/L – 040 dhe nenit 78 paragrafi f, të Statusit të Komunës së Kamenicës dhe Shkresës Sh.02. nr.35306 të datës 17.11.2015, nga PMN Sh.p.k, në Prishtinë, ka marrë vendim për formimin e këtij Komisioni i cili përbëhej nga tre anëtarë dhe atë S.P., S.M. dhe H. J. si Kryetar i Komisionit, për projektin “Kyqja e Energjisë Elektrike te Shkolla e re në fshatin Rogoçicë, Komuna e Kamenicës, me detyrat sipas këtij vendimi dhe për këtë është njoftuar Zyra Kryetarit, Punëkryesi, Organi Mbikqyrës, Antarët e Komisionit dhe Zyra e Prokurimit dhe QSHQ – Arkivi.

Në bazë të konkursit për plotesimin e vendeve të punës i datës 06.11.2019, i hapur nga Komuna e Kamenicës, gjykata vërtetoi faktin se Zyra e Kryetarit të Komunës Z.Qëndron Kastrati, më date 31.10.2019, në bazë të nenit 7 dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 Ligjit te Punës, Udhezimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 per Rregullimin e Procedurave në Sektorin Publik neni 4 dhe 5 si dhe kerkesa nr. 02/22246 e datës 25.07.2019 e parashtruar nga Udhëheqësi i SH.K, Komuna e Kamenicës ka shpallë konkurs per plotësimin e vendit të punës për Mirembajtës të Objektivit në Institucionin Komuna e Kamenicës, Departamenti/Drejtoria Drejtoria per Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale, Divizioni/Njesia: Shtepia e Komuniteteve, me llojin e pozitës së karrierës, me akt emërimim të punës, Orar te plote, titulli i mbikëqyrqsit udhëheqësit e Shtepisë së Komuniteteve, me koeficientin 5, Pagë Bruto 327.60, Mbulese buxhetore sipas ligjit te buxhetit, Orët e punes 40 ore, me detyra për kujdesin për mirëmbajtjen e nyjeve sanitare te institucionit, dyerve dritareve etj.

Në bazë të vendimit për caktimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave me nr.046, të datës 11.06.2018, i lëshuar nga Zyra e Prokurimit të Komunës së Kamenicës, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti përbëhej nga B.K. anëtar nga DSHPAI, S. P.anëtar nga DKRS dhe R.B. anëtar nga DSHPAI, për rregullimin dhe mirëmbajtjen e ndriqimit publik në qytet dhe fshatra, i nënshkruar nga Kryetari i Komunës Z.Q. K. dhe Menaxheri i Prokurimit E. K..

2.2. Dëshmia e dëshmitarit

Dëshmitari A. A. nga, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.02.2024, ka deklaruar se S. P., ka qenë i punësuar në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, në Komunën e Kamenicës, kryesisht në shtëpinë e kulturës, në poziten e Rojtarit të shtëpisë së Kulturës në Kamenicë.

Tutje ka theksuar se S. P. ka qenë i angazhuar si punëtor në Palestrën e Sportit në Kamenicë, në objektin e ri, si mirëmbajtës i Palestrës, nga viti 2015 deri në vitin 2021, dhe gjatë kësaj kohe ka theksuar se, S.P. si mirëmbajtës i Palestrës është marrë me mirëmbajtjen e ujësjellsit, rrymës, pastrimin e objektit. Po ashtu, dëshmitari ka theksuar se Safet Peci, para vitit 2015, ka punuar si rojtar në Shtepinë e kulturës në Kamenicë. Ndërsa, prej vitit 2015 ka qenë i angazhuar vetëm për mirëmbajtjen e palestrës së sporteve në Kamenicë, dhe e ka pasur orarin e rregullt si çdo punëtor tjetër në Komunën e Kamenicës. Tutje ka theksuar se Kryetari i Komunës së Kamenicës, B. S., e ka angazhuar S.P., për mirembajtjen e Palestres së Sportëve në Kamenicë, mirëpo nuk i ka lëshuar vendim me shkrim. Ndërsa, në vitin 2017, dëshmitari ka theksuar se, Kryetari i Komunës së Kamenicës, Q. K., e ka lëshuar një vendim për S.P., dhe në atë vendim S. P. është caktuar si mirëmbajtës i Palestrës së Sporteve, me obligime që t'i kryej të gjitha punët rreth Palestrës dhe mirëmbajtjes së saj. Tutje, dëshmitari ka theksuar se, Mirembajtësi e ka pagën më të lartë se sa Rojtari. Dëshmitari ka deklaruar se ka qenë epror i drejtperdrejtë i punëtorit, tani paditësit S. P., dhe e ka bërë vlerësimin e punës se tij.

2.3. Deklarata e paditësit S.P.në cilësi të palës

Paditësi S. P. nga, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 30.01.2024, ka deklaruar se nga viti 2008 e deri në vitin 2015, ka qenë duke punuar në pozitën e rojtarit të DKRS, në shtepinë e kulturës në Kamenicë, mirëpo ka theksuar se në vitin 2015, Kryetari i Komunës së Kamenicës, B. S., të njëjtin, A. A. dhe A.K., i ka caktuar që t'i mbikqyrin punimet e ndërtimit të sallës së sporteve në Kamenicë. Tutje, ka shtuar se Kryetari i Komunës dhe drejtori i DKRS-së, në atë kohë nuk kanë marrë vendim me shkrim që të njëjtit të caktohen në detyrat e lartëcekura, por i ka caktuar vetëm me gojë. Paditësi ka shtuar se më datë 10.01.2018, Kryetari i Komunës së Kamenicës, Q. K., i ka lëshuar një vendim me shkrim dhe e ka obliguar që përveq punëve dhe detyrave si rojtar të bëjë edhe mirëmbajtjen e objektit të palestrës, ndërsa para vitit 2018, ka theksuar se asnjëherë nuk ka pasur ndonjë obligim shtesë në punë përtej atyre që i ka pasur si rojtar i objektit të DKRS-së, si dhe ka shtuar se nga viti 2008, deri në vitin 2015, si rojtar i DKRS është paguar me pagë mujore prej 280.00 euro, ndërsa pas vitit 2015 deri në vitin 2018, nuk ka marrë pagë me tepër se 280.00 euro, edhe pse ka qenë i ngarkuar me përgjegjësi për mbikqyrjen e ndërtimit të objektit të sallës së sporteve në Kamenicë. Po ashtu, paditësi ka theksuar se paga e rojtarit që e ka marrë i njëjti dhe paga e mirëmbajtësit dallon, pra paga e mirëmbajtësit sipas të njëjtit është më lartë, respektivisht paga për mirëmbajtësin është rreth 320.00 euro.

3. Baza juridike

Në bazë të Ligjit të Punës me nr. Ligji Nr. 03/L-212, respektivisht nenit 10, paragrafi 1, të këtij ligji është paraparë se *“kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji”*, ndërsa paragrafi 2 i po këtij ligji parasheh se *“kontrata e punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra*

specifike". Ndërsa neni 55 i po këtij ligji, paragrafi 1 parasheh që *"i punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësi"*, Ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni parasheh *"të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës"*. Po ashtu, duke u bazuar në dispozitën e nenit 78 paragrafi 1, të Ligjit të Punës, me Nr. 03/L-2012, ku përcaktohet se *"I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura"* ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se *"Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës"*, si dhe në bazë të paragrafit 3, të po të këtij neni *"Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh"*, poashtu në dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës së lartëcekur, përcaktohet se *"Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente"*, si dhe në dispozitën e nenit 17 paragrafi 1, të të njëjtit Ligj, ku përcaktohet se *"I punësuar caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune"*, si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 13 të Konventes Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (e cila ka hyrë në fuqi me 1 shtator 1953) ku përcaktohet se *"Çdo njeri të cilit i shkelen të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë konventë duhet të ketë një mjet ligjor efektiv para një autoriteti kombëtar, pavarësisht nga fakti se shkeljen e kanë kryer personat që veprojnë në cilësi zyrtare"*, gjykata erdhi në përfundim se padia dhe kërkesëpadia e paditësit aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa, duke u bazuar në nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është përcaktuar se *"palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla"*. si dhe në nenin 319 paragrafi 1, të LPK-së, ku është përcaktuar se *"Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta"*, gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadiës si të pabazuar.

4. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Duke i pasur parasysh provat materiale, dëshmin e dëshmitarit dhe deklaratën e vet paditësit, të cekura si më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit S. P., është pjesërisht e bazuar në ligj, ashtu që në bazë të këtij konstatimi gjykata ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësit, përmes së cilës ka kërkuar diferencën e pagës dhe atë nga viti 2015 deri në vitin 2021, për 72 muaj, në diferencë të pagës për 43.84 euro në muaj, e gjithësej në shumën prej

3,156.00 euro, t'a aprovoj pjesërisht si të bazuar, sikurse në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e diferencës së pagës për periudhën kohore nga janari i vitit 2018 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, gjithësej për 48 muaj, në shumë prej 2,104.32 euro, e ka vërtetuar në bazë të dispozitave ligjore të cekura si më lartë, ngase është fakt i pa kontestueshëm se i punësuari i cili angazhohet nga punëdhënësi për të kryer detyra dhe punë shtesë përtej atyre të cilat i ka të përcaktuar me kontratën e punës, i takon kompensimi në të holla për punën shtesë të cilën i punësuari e kryen. Ndërsa në anën tjetër gjykata, faktin se i punësuari, respektivisht tani paditësi S. P., ka kryer detyra dhe punë shtesë me kërkesën e punëdhënësit të tij, tani të paditurës DKRS – Komuna e Kamenicës, e ka vërtetuar në bazë të provës materiale, njoftimit të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Kamenicës, me numër 02-844, të datës 10.11.2018, përmes të cilit njoftim, paditësi S.P. është obliguar që krahas punëve dhe detyrave tjera të bëjë edhe mirëmbajtjen e objektit të palestres, deri në një ri-organizim të ri me orar nga ora 16:00 deri në 22:00, edhe përkundër faktit se paditësi S. P., ka qenë i punësuar tek e paditura me kontratë të rregullt të punës, në pozitën roje e objektit, të shtëpisë së Kulturës në Kamenicë, fakt të cilin gjykata e ka vërtetuar në bazë të kontratës për marrëdhënien e punës me numër 02/40229, të datës 30.12.2019.

Ndërsa, faktin se paditësi S. P., ka qenë i angazhuar në detyra dhe punë shtesë përtej pozitës së tij si roje e objektit, të shtëpisë së Kulturës në Kamenicë, nga punëdhënësi i tij DKRS – Komuna e Kamenicës, Gjykata e ka vërtetuar edhe në bazë të dëshmisë së dëshmitarit A. A., i cili gjatë dëshmisë së tij në shqyrtimin kryesor, ka deklaruar se paditësi Safet Peci, ka qenë i angazhuar si punëtor në Palestrën e Sportit në Kamenicë, në objektin e ri, si mirëmbajtës i Palestrës, nga viti 2015 deri në vitin 2021, dhe gjatë kësaj kohe ka theksuar se S. P. si mirëmbajtës i Palestrës është marrë me mirëmbajtjen e ujësjesit, rrymës, pastrimin e objektit, respektivisht ka deklaruar se nga viti 2015, paditësi S.P., ka qenë i angazhuar vetëm për mirëmbajtjen e palestrës së sporteve në Kamenicë, dhe e ka pasur orarin e rregullt si çdo punëtor tjetër në Komunën e Kamenicës, e të cilës deklaratë gjykata i'a fali besimin e plotë dhe e mori për bazë, ngase e njëjta ishte e sinqert, e kjo, dhe në harmoni të plotë me provat e tjera materiale, aq më tepër kur edhe i njëjti ka deklaruar se ka qenë epror i drejtëpërdrejtë dhe e ka bërë vlerësimin e punës së paditësit S.P..

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit, të cilën gjykata i'a ka njohur, sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e ka vërtetuar në bazë të kontratës për marrëdhënien e punës me numër 02/40229, të datës 30.12.2019, përmes së cilës është vërtetuar se paditësi S. P., si rojtar i objektit të shtëpisë së kulturës në Kamenicë, pagën bruto e ka pasur 283.76 euro, ndërsa në bazë të konkursit për plotësimin e vendit të punës me numër 02/35071, të datës 06.11.2019, të shpallur nga Komuna e Kamenicës, gjykata ka vërtetuar se punëtori në pozitën mirëmbajtës i objektit, e ka pagën bruto 327.60 euro, dhe meqenëse në mënyrë të pakontesueshme, nga provat materiale dhe personale të elaboruar si më lartë, është vërtetuar se paditësi S. P., përveq pozitës së tij si roje i objektit të shtëpisë së Kulturës në Kamenicë, ka punuar edhe punë shtesë si mirëmbajtës i objektit të palestrës së sporteve në Kamenicë, mirëpo nuk është kompensuar me pagën që do t'i takonte si mirëmbajtës i objektit, por është paguar me pagën e rojes së objektit, e që në bazë të provave të lartëcekura, vërtetohet se paga e

punëtorit me pozitën mirëmbajtës i objektit, është më e lartë se sa paga e punëtorit me pozitën roje e objektit. Ndërsa, në anën tjetër e paditura nuk e ka argumentuar në asnjë mënyrë se paditësin S.P., e ka kompensuar për punët shtesë, për të cilat e kanë ngarkuar për t'i kryer, përveq pozitës së tij të cilëne ka pasur si roje e objektit të shtëpisë së Kulturës në Kamenicë. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha të lartëcekurat, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar në ligj, sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të të paditueses DKRS në Komunën e Kamenicës, se paditësi nuk i ka shtjerrur mjetet e brendshme juridike, në procedurën administrative tek punëdhënësi i tij, dhe pa i shtjerrur këto mjete juridike ka paraqitur padi në Gjykatë, për gjykatën, ky pretendim është irelevant (i pa rëndësishëm), dhe gjykata nuk e mori parasysh në rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, ngase në rastet kur kërkesa e palës paditëse ka të bëjë me kërkesa në të holla, paditësi nuk e ka për obligim ligjor konform dispozitave të Ligjit të Punës me nr. Ligji Nr. 03/L-212, t'i shtjerrë paraprakisht mjetet e brendshme juridike tek punëdhënësi i tij, por i njëjti ka të drejtë, që drejtpërdrejtë të paraqesë padi në gjykatë, për të kërkuar realizmin e të drejtës së tij të pretenduar, siç ka vepruar në rastin konkret edhe paditësi S.P..

Gjykata, vendosi sikurse në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe e refuzoi si të pabazuar në ligj, pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që të njëjtit t'ia kompensojë diferencën e pagës, edhe për periudhën nga muaji janar i vitit 2015 deri në muajin dhjetor të vitit 2017, respektivisht edhe për 36 muaj, nga 43.84 euro për çdo muaj, e në shumë të përgjithshme prej 1,578.24 euro, ngase duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës me nr. Ligji Nr. 03/L-212, ku është përcaktuar se “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, si dhe duke pasur parasysh që i autorizuari i palës së paditur gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi për shkak të kalimit të afatit ligjor, brenda të cilit afat ka pasur të drejtë pala paditëse t'a kërkojë kompensimin e diferencës së pagës së pa paguar, pra pala e paditur është thirrur në parashkrimin e të drejtës së kërkesës së palës paditëse për kompensimin e diferencës së pagës, konform nenit 87 të Ligjit të Punës, e rrjedhimisht gjykata, pjesën e kërkesëpadisë së cekur si më lartë e refuzoi si të pa bazuar në ligj, për shkak se gjykata ka vërtetuar se pjesa e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e diferencës së pagës, për periudhën kohore nga muaji janar i vitit 2015 e deri në muajin dhjetor të vitit 2017, është parashkruar.

5. Shpenzimet e procedurës kontestimore

Gjykata, vendosi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore duke u mbështetur në dispozitën e nenit 452 paragrafi 1, të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe në bazë të Tarifës së zbatuar të Odes së Avokatëve të Kosovës, e që në rastin konkret gjykata erdhi në përfundim se paditësit duhet t'i njihen shpenzimet e procedurës dhe atë në shumën prej 540.00 euro, në emër të përfaqësimit nga i autorizuari i tij në 4 (katër) seanca gjyqësore, për secilen seancë nga 135.00 euro.

Nga të lartëcekurat e bazuar në dispozitat e lartëcekur, si dhe në dispozitën e nenit 143, paragrafi 1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C. nr. 702/2020, i datës 16.04.2024

G j y q t a r i

Artan Abazi, d. v

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimi të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.